



Kom.Dh.Shk.II.nr.1466/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Bill Klinton”, kundër debitorit Posta e Kosovës, me seli në Prishtinë, rr. “Kajtaz Ramadani”, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr. 869/22 të datës 25.05.2023, me datë 16.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e debitorit Posta e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr. 869/22 të datës 25.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 869/22 të datës 25.05.2023, më pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimi e debitorit Posta e Kosovës dhe ka anuluar pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.2156/18 i datës 12.07.2018, i Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, për pjesën e detyrimit në shumën prej 768.40 €. Në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit Posta e Kosovës dhe ka mbetur në fuqi pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.2156/18 i datës 12.07.2018, i Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, sa i përket shumës prej 418.48 €, së bashku me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%. Në pikën III të dispozitivit e ka përfunduar pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi Sh.A., ndaj debitorit Posta e Kosovës, sipas urdhërit përmbartimor P.r.2156/18 i datës 12.07.2018, për shumën prej 768.40 €.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitorit Posta e Kosovës, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr. 869/22 të datës 25.05.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit, dhe të ndryshohet pika II d aktvendimi

KPPP.nr. 869/22 të datës 25.05.2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë dhe të shfuqizohet refuzohet Urdhri Përmbarrimor P.nr.2156/18 i datës 12.07.2018.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi Sh.A., me datën 09.07.2018 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarrimit, kundër debitorit Posta e Kosovës, në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstrakti të verifikuar afarist- me nr. ID 127990 në shumë prej 1,186.88 €.

Përmbarruesi Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi Sh.A., ka caktuar urdhrin P.nr.2156/18 i datës 12.07.2018, duke lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstrakti të verifikuar afarist- me nr. ID 127990 për periudhën 06.03.2014 deri 31.05.2018, me të cilat i ka urdhëruar debitorin Posta e Kosovës, që brenda 7 ditësh pas pranimit të urdhërit, të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar shumë prej 1,186.88 €, me kamat ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbarrimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbarrimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbarrimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 869/22 të datës 25.05.2023, më pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimi e debitorit Posta e Kosovës dhe ka anuluar pjesërisht Urdhri Përmbarrimor P.nr.2156/18 i datës 12.07.2018, i Përmbarruesit Privat

Destan Bujupaj, për pjesën e detyrimit në shumën prej 768.40 €. Në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit Posta e Kosovës dhe ka mbetur në fuqi pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.2156/18 i datës 12.07.2018, i Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, sa i përket shumës prej 418.48 €, së bashku me kumatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%. Në pikën III të dispozitivit e ka përfunduar pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturave Pastrimi Sh.A., ndaj debitorit Posta e Kosovës, sipas urdhërit përmbartimor P.r.2156/18 i datës 12.07.2018, për shumën prej 768.40 €.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret Ekstrakti të verifikuar afarist- me nr. ID për periudhën 06.03.2014 deri 31.05.2018, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokumenti i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *"Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm"*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *"Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar"*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *"Kur propozimi për përmbartim paraqitet në baze të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit."*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturave, janë përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht Kartelën e Konsumatorit - ekstraktin e verifikuar nga librat afariste me nr. ID 127990, e cila periudhën kohore nga 06.03.2014 deri 31.05.2018, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në të janë treguar palët, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kartela e Konsumatorit - ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, me nr.ID, e cila përfshin periudhën kohore nga data 06.03.2014 deri 31.05.2018, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është e dorëzuar në kopje të verifikuara. Kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar ku sipas dispozitës nga neni 355 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet

se "1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite". Ndërsa me paragrafin 2 të të njëjtit nen përcaktohet se: "Parashkrimi rrjedh veç e ves për do dërgim të mallit, punë ose shërbimi të kryer". Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e ves, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat nga data 06.03.2014 deri me datën 01.07.2015 në shumën prej 768.40 €, janë parashkruar sipas nenit 355 të LMD-së, pasi që propozimi i kreditorit për përmbarim është paraqitur me datë 09.07.2018, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar me tepër se 3 (tre) vite nga koha e maturimit/arritjes për pagesë. Ndërsa sa i përket borxhit sipas faturave për periudhën kohore nga data 03.08.2015 deri me datë 31.05.2018, gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim - parashkrim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 355 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet afati 3 (tre) vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve lidhur me këto kontrata, ndërsa parashkrimi rrjedh veç e veç për cdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer, e që në rastin konkret për secilën nga kërkesat sipas faturave për periudhën nga data 03.08.2015 deri me 31.05.2018, nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se kreditori me datë 09.07.2018 ka ushtruar propozim për përmbarim, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, prandaj gjykata ka vendosur se duhet pjesërisht të aprovoj sot ë bazuar prapësimin e debitorit për shumën 768.88 euro, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit. Ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar prapësimin e debitorit për shumën prej 418.48 euro pasi që borxhi për këtë shumë nuk është parashkruar, gjykata ka lënë kamatën 8% duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: "Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitor, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën", për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 418.48 €, me ka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive. Gjukata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit duke u bazuar në nenin 12 para. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: "Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera". Gjukata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin të këtij aktvendimi të atakuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbimore me rastin e vendosjes në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimi e debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se kemi të bëjmë me parashkrim të faturave nga urdhëri përmbimore P.nr.2156/18 i datës 12.07.2018 për faturat nga data 06.03.2014 deri me 01.07.2015. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 355 par.1 i LMD-së, i cili përcakton se *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”* dhe paragrafin 2 të këtij neni përcakton se *“Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*. Sa i përket periudhës si në pikën II, e refuzoi prapësimin e debitorit për shumën prej 418.48 euro pasi që nuk kemi parashkrim, dhe ka lënë kamatën 8% duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitor, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e këtij detyrimi dhe në pikën III ka vendosur sipas nenit 12 para. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se ekstrakti si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbimore, respektivisht është lejuar përmbimi i plotësion kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Mirëpo në rastin konkret qartë rezulton se nga ekstrakti për periudhën e lartëcekur, faturat që janë përshkruar si në urdhërin përmbimore. Meqenëse ekstrakti financiar i paraqitur si dokument i besueshëm është paraqitur në tërësi nga viti 2013 deri vitin 2021 pra sipas nenit 29 dhe 37 të LPP-së.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përbarimore organi përbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv. Fakti se kreditori ka dorëzuar ekstraktin që janë faturat përmes këtij urdhëri përbarimor është evidente, mirëpo këto faturime janë sipas periudhave mujore nga shërbimet e ofruara nga kreditori, pjesa e borxhit të ka mbetur sipas periudhave të lartëcekura 2014-2015 janë parashkruar dhe në gjykat nuk mundë të konsiderohet i rregullt dhe nuk nënkupton se mund të anashkalohen prerogativat ligjore të parapara me dispozitat e nenit 355 par.1 dhe par. 2 të LMD-së, ndërsa për pjesën tjetër nuk kemi borxh të parashkruar si në dispozitiv të aktvendimit të gjykatës shkallës së parë.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1466/23 dt. 16.04.2024

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj-Sheremeti